



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1075 Prot.

Tiranë, më 02.09.2024

VENDIM

Nr. 2, datë 02.09.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARIT TË
SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Mbështetur në nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 23, pika 5 të Statutit të Universitetit të Arteve, si dhe në shkresën nr. 1066, datë 02.09.2024 të Rektorit të Universitetit të Arteve, me lëndë: “Propozim mbi zgjedhjen e nënkryetarit të Senatit Akademik, në UART”, Senati Akademik i Universitetit të Arteve pasi diskutoi mbi këtë propozim, me votim të hapur dhe unanim,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit për zgjedhjen e **Prof. Najada HAMZA Nënkyetare të Senatit Akademik** të Universitetit të Arteve.
2. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert CELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1066 prot.

Tiranë, më 2/09/2024

Lënda: Propozim mbi zgjedhjen e nënkryetarit të Senatit Akademik, në UART

**Senatit Akademik
Universiteti i Arteve Tiranë**

Të nderuar anëtarë të Senatit Akademik

Mbështetur në pikën 5, të nenit 23 Senati Akademik, të Statutit të Universitetit të Arteve miratuar me VSA nr. 15, datë 30.08.2021 i ndryshuar me VSA nr. 27/2, datë 07.02.2024, ku shkruhet: *Senati Akademik në mbledhjen e tij të parë me propozim të Rektorit, zgjedh nënkryetarin.*

Në këtë pozicion unë propozoj Prof. Najada Hamza.

Prof. Najada Hamza që nga viti 1988 e në vazhdim është pedagoge pranë Fakultetit të Arteve të Bukura dhe prej vitit 2008 e në vazhdim mban titullin akademik Profesor.

Karriera akademike në Universitetin e Arteve është shumë e pasur dhe gjithmonë në ngritje, ku vlen të përmendim:

1. 1993- Shefe e Labororit te Arteve te Aplikuara, Fakulteti i Arteve te Bukura, Akademia e Arteve, Tirane.
2. 1994-Present, Shefe e Seksionit të Tekstilit dhe Modës, Fakulteti i Arteve të Bukura Tiranë.
3. 2000-2004 Anëtare e Bordit të Programit Art-Kulture, Soros Foundation.
4. 2006 Shefe e Departamentit, Fakulteti i Arteve Pamore, Akademia e Arteve, Tiranë.
5. 2006 Anëtare e Bordit, Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë.
6. 2008-2013 Anëtare e Bordit të Kulturës, Ministria e Kulturës.
7. 2008-2012 Kryetare e Bordit të Administrimit, Akademia e Arteve, Tiranë.
8. 2012- 2016 Anëtare e Bordit të Administrimit, Universiteti i Arteve, Tiranë.
9. 2016- Anëtare e Senatit Akademik, Universiteti i Arteve, Tiranë.

Në aspektin artistik krijimtaria e Prof. Najada Hamza renditet në forumet më larta të artit Shqiptar por edhe atij ndërkombëtar.

Nëse do të filloja të rendisja apo të përmendja për Prof. Najada Hamza



1. Aktivitet pedagogjik/ kurime ekspozitash;
2. Bùrsa/çmime;
3. Ekspozita
4. Publikime dhe katalogë;
5. Konferenca/ leksione/ trajnime;
6. Bashkëpunimi kombëtare dhe ndërkombëtarë,

do të ishin shumë faqe në këtë propozim timin të karrierës së saj profesionale dhe artistike dhe kush dëshiron bashkëlidhur kësaj shkrese ka edhe jetëshkrimin e Prof. Najada Hamza.

Nisur nga sa më sipër dhe referuar jetëshkrimit të saj të plotë, bashkëngjitur, besoj se Prof. Najada Hamza, zotëron aftësitë e duhura për realizimin e pozicionit të nënkryetarit të Senatit Akademik.

Me respekt,

REKTOR

Prof. Dr. Erald Bakalli

